



Komisioni  
Evropian



## ÇFARË JANË STRATEGJITË MAKRO-RAJONALE TË BE-SË?

Strategjia makro-rajonale e Bashkimit Evropian (BE-së) është një kuadër politik që u lejon vendeve që ndodhen në të njëjtin rajon të trajtojnë dhe të gjejnë në mënyrë të përbashkët zgjidhje për problemet ose për të përdorur sa më mirë potencialin e tyre të përbashkët (p.sh. ndotja, lundrimi, konkurrenca e biznesit në nivel botëror etj.). Duke vepruar kështu, ata përfitojnë nga forcimi i bashkëpunimit, me synim që t'i bëjnë politikat e tyre më efektive sesa nëse do t'u adresoheshin problemeve të izoluar nga njëri-tjetri. Strategjitë makro-rajonale e BE-së mund të mbështeten nga fondet e BE-së, duke përfshirë Fondin Evropian Struktural dhe të Investimeve (ESIF).

Për të rritur shanset e suksesit për strategjitë makro-rajonale të BE-së, partnerët e përfshirë (shtetet anëtare, rajonet, komunat, OJQ-të etj.) duhet t'i bazojnë veprimet e tyre në disa parime kyçe: një partneritet i rëndësishëm dhe një mekanizëm i përshtatshëm bashkëpunimi, koordinimi i mirë i veprimeve në lidhje me politikat përkatëse dhe burimet për financimin e tyre, si edhe një frymë e lartë bashkëpunimi brenda dhe mes vendeve dhe sektorëve në makro-rajon.

## KUSH JANË NISMËTARËT E STRATEGJIVE?

Strategjitë makro-rajonale të BE-së bëhen me nismën dhe kërkesën e shteteve anëtare të interesuara të BE-së (dhe në disa raste nga vende jashtë BE-së) që ndodhen brenda të njëjtës zonë gjeografike, përmes Këshillit të Evropës. Pas kërkesës së Këshillit të Evropës, strategjitë hartohen dhe miratohen nga Komisioni Evropian.

Prandaj, strategjitë janë nisma krejtësisht ndërqeveritare dhe implementimi i tyre mbështetet pothuajse krejtësisht në angazhimin dhe vullnetin e mirë të vendeve pjesëmarrëse. Procesi është po aq i rëndësishëm sa edhe rezultati: ai duhet të jetë përfshirës dhe duke filluar nga baza lart për të garantuar pjesëmarrjen.

## CILAT JANË KARAKTERISTIKAT KRYESORE?

Strategjitë nuk vijnë me fonde, legjislacion ose struktura formale të reja nga BE-ja: ato mbështeten te koordinimi dhe sinergjia. Kjo nënkupton përdorim optimal të të gjitha burimeve ekzistuese financiare (ato të BE-së, kombëtare, rajonale, private etj.), implementim më të mirë të legjislacionit ekzistues, si dhe përdorim më të mirë të institucioneve ekzistuese në të gjitha nivelet.

Strategjitë makro-rajonale të BE-së u adresohen sfidave dhe mundësive specifike për zonat e caktuara gjeografike që janë tepër lokale për të qenë në interesin e drejtpërdrejtë të të gjithë BE-së, por tepër të gjera për t'u trajtuar me efikasitet në nivel kombëtar. Me fjalë të tjera, ato veprojnë si urë lidhëse mes politikëbërjes së BE-së dhe asaj lokale.

Objektivat e strategjive janë strategjike, afatgjata dhe të miratuara bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse. Ato variojnë sipas nevojave të makro-rajonit në fjalë, dhe duhet t'u jepet përparësi çështjeve strategjike që sjellin vlerë të shtuar në politikat horizontale të BE-së.

Secila strategji përfshin një gamë të gjerë faktorësh në nivele (ndërkombëtare, kombëtare, rajonale, lokale), sektorë (publikë, privatë, shoqëri civile) dhe fusha ekspertize të ndryshme, duke ofruar kështu një platformë për administrim konsekuent mes shumë vendeve, sektorëve dhe niveleve.

**Deri më sot, janë miratuar katër strategji makro-rajonale të BE-së; secila shoqërohet nga një plan masash me faza që përditësohet rregullisht sipas nevojave të reja që lindin dhe ndryshimit të kontekstit:**

- Strategjia e BE-së për Rajonin e Detit Baltik (2009);
- Strategjia e BE-së për Rajonin e Danubit (2010);
- Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (2014); dhe
- Strategjia e BE-së për Rajonin Alpin (2015).

**Ato lidhen me 19 shtete anëtare të BE-së dhe 8 vende jo-anëtare të BE-së, që përfaqësojnë mbi 340 milionë njerëz<sup>1</sup>:**

- **19 SHTETE ANËTARE TË BE-SË:** Austria, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Republika Sllovaqe, Sllovenia dhe Suedia;
- **8 VENDE JO-ANËTARE TË BE-SË:** Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Lihtenshtejini, Moldavia, Mali i Zi, Serbia, Zvicra dhe Ukraina.

Disa vende të BE-së si Gjermania dhe Sllovenia janë të përfshira në tri strategji, ndërsa Kroacia, Italia dhe Austria janë të përfshira në dy të tilla. Tri vende jo-anëtare të BE-së – Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia – janë pjesë e dy strategjive makro-rajonale të BE-së.

## FAKTORËT KYÇË NË STRATEGJI

Secila strategji makro-rajonale, që përfshin një gamë të gjerë faktorësh të ndryshëm, ka mënyra të ndryshme administrimi, sepse merren në konsideratë specifikat rajonale. Megjithatë, mund të përcaktohen faktorët implementues kyçë të përbashkët.

### Në nivel BE-je

Komisioni Evropian luan një rol kryesues në koordinimin strategjik të fazave kyçe të implementimit të strategjisë. Gjithashtu, një grup i nivelit të lartë i strategjive makro-rajonale të BE-së me përfaqësues nga të 28 shtetet anëtare të BE-së dhe vende jo-anëtare të BE-së të përfshira në strategji, takohet për të shqyrtuar përjasjen e përgjithshme për të gjitha strategjitë makro-rajonale të BE-së.

### Në nivel kombëtar/rajonal

Në secilin vend pjesëmarrës, koordinatoret kombëtarë janë përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe mbështetjen për implementimin e strategjisë në vendin e tyre.

### Në nivel zone tematike

Fushat tematike drejtohen nga koordinatoret e zonave tematike (koordinatoret e zonave të politikave/prioriteteve, veprimet horizontale, shtyllat ose veprimet) që përfaqësojnë interesin makro-rajonal. Ata mbështeten nga homologët e tyre nga rajoni përkatës dhe organizohen në grupe drejtuese. Roli i tyre kryesor është promovimi i krijimit të projekteve të përbashkëta që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave të strategjisë. Përveç kësaj, bazuar në rezultatet dhe suksesin e këtyre projekteve, roli i tyre është influencimi i përmbajtjes dhe implementimi i politikave në vendet dhe rajonet në fjalë, për të përmirësuar pozicionimin global të makro-rajonit në planin afatgjatë.

## BASHKËPUNIMI MES STRATEGJIVE


Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet strategjive të ndryshme makro-rajonale është me rëndësi kyçe me qëllim maksimizimin e përfitimeve të përbashkëta dhe të ndikimit reciprok. Kjo është edhe më e rëndësishme aty ku ka mbivendosje gjeografike mes strategjive. Bashkëpunimi mes strategjive mund të marrë forma të ndryshme (p.sh. implementimi i projekteve të përbashkëta, ndarja e praktikave më të mira dhe përvojës etj.).

### Shembujt përfshijnë:

- Organizimi i javës së strategjive makro-rajonale të BE-së në Slloveni (Portorozh) në shtator 2017, për të shkëmbyer dhe përmirësuar masat e komunikimit;
- Projekti DanuBalt, i cili synon të trajtojë ndasitë në inovacione dhe kërkime në shëndetësi në rajonet e Danubit dhe të Detit Baltik, po implementohet nga grupe interesi nga dyja makro-rajonet;
- Një seminar, i organizuar bashkërisht nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal dhe Programi i Mjedisit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Sarajevë në prill 2016, u dha mundësinë zyrtarëve kyçë nga Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR) dhe Strategjia e BE-së për Rajonin e Danubit (EUSDR) të krahasonin prioritetet në lidhje me sfidat mjedisore në Ballkanin Perëndimor;
- Për shkak të mbivendosjes së konsiderueshme gjeografike mes EUSDR dhe EUSAIR (Sllovenia, Kroacia, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovina), janë zhvilluar takime të përbashkëta për fushat tematike me interes të përbashkët, siç janë transporti, energjia dhe mjedisi. Takime të ngjashme janë zhvilluar mes faktorëve kyçë të EUSDR dhe EUSALP, për shembull në fushën e energjisë.

Si konkluzion, vlera e shtuar e strategjive makro-rajonale karakterizohet nga përjasja e tyre ndërsektoriale, dimensionit i tyre trans-kombëtar (që përfshin pjesëmarrjen e vendeve jo-anëtare të BE-së) dhe kontributi i tyre në një administrim më të mirë mes shumë niveleve. Por ky është një koncept ambicioz që ka nevojë për kohën e vet që të konsolidohet dhe të prodhojë rezultate.

1) Burimi: Eurostat, Banka Botërore, NSI Ukraina



## INFORMACIONE TË MËTEJSHME:

### Strategjitë makro-rajonale të BE-së

[http://ec.europa.eu/regional\\_policy/en/policy/cooperation/macro-regional-strategies/](http://ec.europa.eu/regional_policy/en/policy/cooperation/macro-regional-strategies/)



**Strategjia e BE-së  
për Rajonin e  
Detit Baltik:**  
[www.balticsea-region.eu/](http://www.balticsea-region.eu/)



**Strategjia e BE-së  
për Rajonin  
Adriatiko-Jonian:**  
[www.adriatic-ionic.eu/](http://www.adriatic-ionic.eu/)



**Strategjia e BE-së  
për Rajonin e Danubit:**  
[www.danube-region.eu/](http://www.danube-region.eu/)



**Strategjia e BE-së  
për Rajonin Alpin:**  
[www.alpine-region.eu/](http://www.alpine-region.eu/)



@RegioInterreg, @EU\_Regional



Zyra e Publikimeve

Keni pyetje rreth Bashkimit Evropian?

Për këtë mund t'ju ndihmojë Europe

Direct:

00 800 6 7 8 9 10 11,

<http://europedirect.europa.eu>

Një version interaktiv i këtij

publikimi, që përmban lidhje të

përmbajtja në internet, është i

disponueshëm në format PDF dhe HTML:

[http://ec.europa.eu/regional\\_policy/en/information/publications/](http://ec.europa.eu/regional_policy/en/information/publications/)

© Bashkimi Evropian, 2017

Fotografia shoqëruese: © Creative Commons – Pixabay

Ripërdorimi autorizohet me kusht që të bëhet i ditur burimi.

Politika e ripërdorimit të dokumenteve të Komisionit Evropian rregullohet nga Vendimi Nr. 2011/833/EU (OJ L 330, 14.12.2011, fq. 39).

Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive ose të materialeve të tjera për të cilat të drejtat e autorit nuk i ka BE-ja, duhet të kërkohet leje direkt nga zotëruesit e të drejtave të autorit.

PDF

ISBN 978-92-79-76618-3

doi:10.2776/81984

KN-07-17-103-SQ-N